



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

SESIONI II

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme teknike profesionale(3+2) dhe 5- vjeçare

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Gjergj Elez Alia (fragment)**

| | | |
|-----------------|----------|---------------|
| Pyetja 1 | A | 1 pikë |
| Pyetja 2 | C | 1 pikë |
| Pyetja 3 | D | 1 pikë |
| Pyetja 4 | B | 1 pikë |
| Pyetja 5 | A | 1 pikë |
| Pyetja 6 | C | 1 pikë |
| Pyetja 7 | B | 1 pikë |

Pyetja 8 3 pikë**Model përgjigjeje**

Momentet kryesore të subjektit të fragmentit janë:

- a- amaneti i Gjergjit.
- b- vdekja e Gjergjit dhe ndërrimi i stinës.
- c- qëndrimi ndaj vdekjes dhe konkluzioni se askund nuk gjendet më si Gjergj Elez Alia.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

- 3 pikë** Nëse jep tri momentet kyç.
- 2 pikë** Nëse jep vetëm dy momente kyç.
- 1 pikë** Nëse jep vetëm njërin nga momentet kyç.
- 0 pikë** Nëse përgjigja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 9 2 pikë**Model përgjigjeje**

Detajet janë:

- a- Kur ka nisun **mali me u dushkue**.
- b- Ka gjetë **blinin të tanë degash tha**.

Nxënësi mund të marrë vargjet si më lart, mund të shkëpusë detaje, ose mund të përgjigjet me perifrazim.

- 2 pikë** Nëse jep vetëm dy përgjigjet si në pikat a) b).
- 1 pikë** Nëse jep vetëm njërin nga përgjigjet si në pikat a) b).
- 0 pikë** Nëse përgjigja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 10 4 pikë**Model përgjigjeje**

- a-
 - bli t'bukur
 - emër + mbiemër

b- Kuptimi i vargut është i lidhur me trimërinë e pashoqe të Gjergjit, me mbijetesën e tij të rrallë, me guximin për t'u ndeshur pikërisht në kushtet e tij, me dashurinë e veçantë që ai ka për të motrën që është dashuri për familjen etj.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

4 pikë Nëse gjen tofjalëshin, jep formimin e tij dhe kuptimin e vargut.

3 pikë Nëse jep vetëm tofjalëshin, një anë të formimit dhe kuptimin, ose tofjalëshin dhe formimin.

2 pikë Nëse jep vetëm tofjalëshin dhe një anë të formimit, ose tofjalëshin dhe kuptimin e shprehjes.

1 pikë Nëse jep vetëm tofjalëshin, ose vetëm kuptimin.

0 pikë Nëse jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 3 pikë

Model përgjigjeje

Figura tingullore është:

a- aliteracioni

b- roli i saj është t'u japë muzikalitet ose ritëm vargjeve, tingullim të veçantë, etj.

c- Shembull anafore është:

Ka gjetë blinin të tanë degash tha.

Ka flurue përmbi' i saraj të zi,

ka gjetë kulmin të tanë shembë përdhe.etj.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

3 pikë Nëse jep figurën, shpjegimin dhe anaforën.

2 pikë Nëse jep dy nga përgjigjet më lart.

1 pikë Nëse jep vetëm një nga përgjigjet më lart.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 3 pikë

Model përgjigjeje

Amaneti që Gjergji u lë shokëve duket:

a- solemn, tregon dashuri dhe përkushtim, përgjegjshmëri, mbështetet mbi traditën popullore dhe kombëtare, etj.

b- Fjala *kjaj* është një qarje e thjeshtë ndërsa *gjamë* është pika më e larët e një qarje ose vaji... *Gjamë* në konceptin tonë shpreh dhimbjen dhe humbjen më të madhe, etj.

c- Humbja e Gjergjit trajtohet si gjamë, sepse trim si ai nuk kishte kurrkund dhe do t'i mungonte familjes dhe atdheut, etj.

Pyetja 21 3 pikë**Model përgjigjeje****Mendimet e Plakut në paragrafin e dytë janë të lidhura me:**

- a- Konceptin e të mirës, me disfatën, me të keqen,
- b- Raporti është i lidhur me idenë se e mira nuk mund të fitojë gjithmonë.
- c- Shprehja e tij është e lidhur me mbijetesën dhe shpresën. Njeriu nuk mund ta humbë kurrë shpresën dhe nuk duhet të dorëzohet. Shpirti i njeriut dhe dëshira e tij edhe kur fizikisht është i pamundur jeton dhe gjallon... etj.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

- 3 pikë** Nëse jep tri përgjigje të ngjashme me modelin a) b) c).
- 2 pikë** Nëse jep vetëm dy nga përgjigjet sipas modelit a) b) c).
- 1 pikë** Nëse jep vetëm një nga përgjigjet sipas modelit a) b) c).
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 2 pikë**Model përgjigjeje****Dy mendimet e plakut në fund të fragmentit përmbledhen:**

- a- Plaku thotë të mos kesh shpresë është mëkat.
- b- Por plaku këtu lidh mëkatën me të drejtën për të jetuar. etj

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

- 2 pikë** Nëse jep vetëm dy përgjigje sipas modelit a) b).
- 1 pikë** Nëse jep vetëm një nga përgjigjet sipas modelit a) b).
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 4 pikë**Model përgjigjeje**

- a- sipërore
- b- në raport me kohën
- c- ndonjëherë
- d- ndajfolje

- 4 pikë** Nëse jep katër përgjigje të ngjashme me modelin a) b) c) d).
- 3 pikë** Nëse jep tri nga përgjigjet e ngjashme me modelin a) b) c) d).
- 2 pikë** Nëse jep vetëm dy nga përgjigjet sipas modelit a) b) c) d).
- 1 pikë** Nëse jep vetëm një nga përgjigjet sipas modelit a) b) c) d).
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 **1 pikë****Model përgjigjeje**

Një nga tiparet e stilit të Heminguejit që shfaqet këtu mund të jetë:

- komunikimi monologu ose dialogu me veten, llojet e tij.
- detajet
- konciziteti
- tema ose motivi i shpresës dhe ekzistencës
- thjeshtësia
- parimi i ajzbergut
- stili sugjestionues
- etj

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

1 pikë Nëse gjen vetëm një tipar të stilit të Heminguejit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku përshkruan motivin e fatit dhe përpjekjet e njeriut për ta sfiduar atë..
- përshkruan pse ndodh kjo dhe si ndodh kjo.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga fragmenti ose vepra.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.